



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Vendimit të Kuvendit të Komunës për hartimin e projektit të programit komunal trevjeçar për banim Nr.15-360-79229 të datës 20.12.2019 neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians –VORAE dhe Komunës së Lipjanit 1-360-19866 e datës 29.05.2020, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKT TË PROGRAMIT KOMUNAL
TREVJEQAR PËR BANIM 2021-2024

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për hartimin e Projektit të Programit komunal trevjeçar për banim 2021-2024, në vazhdim të tekstit Komisioni, në përbërje si vijon:

1. Hanushe Berisha, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kryesuese
2. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
3. Lumnije Ejupi, Sektori pronësor juridik, anëtare
4. Lorik Bërbatovci, Qendra për punë sociale, anëtar
5. Driton Tafallari, ekspert nga OJQ "VORAE", anëtar
6. Fatmir Goliqi, Zyra Lokale për komunitete, anëtar

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe puna e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që duke u bazuar në dispozitat ligjore të hartojë Projektin e Programit komunal trevjeçar për banim 2021-2024 më së largu me datë 31.01.2021

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.360-3399 për formimin e komisionit për hartimin e projektit të Programit Komunal trevjeçar për banim 2020-2023 i datës 17.01.2020.

1Nr. 360-61095
Lipjan, më 17.12.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

